REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST DHE TURIZMIT

## Janar 2024

| Nr. (1) | Data e regjistrimit të kërkesës (2) | Objekti (3) | Data e kthimit të përgjigjes (4) | Përgjigja(5) | Statusi i kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8.01.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me: Duam të dimë ndarjen, sa nga paratë e fondit kanë shkuar për ndërtimin e aplikacionit TEA, dhe si funksionon ky aplikacion? Sa kushton mirëmbajtja aktuale pas ndërtimit dhe si bëhet hedhja e | 8.01.2024 | Deleguar te Agjencia Kombëtare e Turizmit. | Përfunduar. | 0 |

<table>
<tr><td></td><td></td><td>të dhënave. Sa i kushton shtetit mirëmbajtja vjetore e TEA?</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>2</td><td>9.01.2024</td><td>Kërkesë për informacion ne lidhje me: numrin mujor të turistëve që kanë vizituar Vlorën gjatë viteve te fundit. (te paktën 5-10 vitet e fundit)<br>Qëllimi i kërkesës sime është të mbledh të dhëna zyrtare për turizmin në qytetin tonë për efekt studimi akademik.<br>Informacioni i dërguar do të përfshihet ne studim nga unë dhe do të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në kërkesë.</td><td>12.01.2024</td><td>Të dhëna statistikore për turizmin në prefekturën Vlorë<br>Është e vështirë nga të dhënat që disponojmë që të nxjerrim të dhëna mbi numrin e turistëve me Qarqe, gjithsesi i jemi referuar tre të dhënave:<br>(i) Strukturave Akomoduese nga procesi i certifikimit që ka ndërmarr Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ;<br>(ii) Nga numri i vizitorëve që vizitojnë Institucionet e Kulturës në Qarkun e Vlorës;<br>(iii) Nga numri i vizitorëve të huaj dhe vendas që vizitojnë Zonat e Mbrojtura të Qarkut Vlorë.<br>(i) Numri i hoteleve të Prefekturës Vlore deri në dhjetor të 2023, rezulton se ka 461 struktura akomoduese te certifikuara. Më poshtë po japim tabelën me numrin e strukturave sipas bashkive të kësaj prefekture dhe llojit të strukturës:
<table>
<tr><th>Qyteti</th><th>Bujtine</th><th>Fjetinë (Hostel)</th><th>Kamping</th><th>Hotel</th><th>Motel</th><th>Resort</th><th>Qendër kurative</th><th>Fjetje dhe mëngjes (B&B)</th><th>Total</th></tr>
<tr><td>Saranda</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td><td>86</td><td>1</td><td>1</td><td>0</td><td>22</td><td>111</td></tr>
<tr><td>Vlora</td><td>2</td><td>1</td><td>0</td><td>79</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>16</td><td>99</td></tr>
</table></td><td>Përfunduar</td><td>0</td></tr>
</table>

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Orikum | 1 | 1 | 1 | 30 | 0 | 0 | 0 | 7 | 40 |
| Himare | 3 | 1 | 4 | 72 | 0 | 0 | 0 | 50 | 130 |
| Ksamil | 1 | 0 | 1 | 56 | 0 | 0 | 0 | 23 | 81 |
| **Qarku Vlore** | **8** | **3** | **6** | **323** | **1** | **2** | **0** | **118** | **461** |

(ii) Numri i vizitorëve në Institucionet e Kulturës për qarkun e Vlorës gjatë 2023 kanë qenë 222 mijë vizitorë Më poshtë gjeni krahasimin midis vitit 2022-2023 si dhe të ardhurat e gjeneruara për 2023.

| INSTITUCIONI I KULTURES | 2022 | 2023 | Rritja në % | Vlera në lek për 2023 |
|---|---|---|---|---|
| MUZEU I PAVARSISË VLORË | 6,751 | 8,167 | 21% | 461,400 |
| KALAJA PORTOPALERMOS | 13,320 | 17,691 | 33% | 5,292,000 |
| KALAJA E KANINËS | 1,087 | 3,166 | 191% | 645,400 |
| KALAJA E HIMARËS | 2,603 | 26,989 | 937% | 944,200 |
| PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA | 1,060 | 794 | -25% | 161,250 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM** | 1,391 | 1,682 | 21% | 288,700 |
| **PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT** | 85,409 | 119,125 | 39% | 77,582,100 |
| **PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ** | 1,039 | 910 | -12% | 222,000 |
| **TOTAL** | **114,682** | **180,547** | **57%** | **85,597,050** |

*Burimi: Ministria e Kulturës*

(ii) Qarku i Vlorës ofron dhe zona të mbrojtura që janë mjaft atraktive si për vizitorët e huaj po ashtu dhe për ata vendas.

Sipas Agjencisë së Zonave të Mbrojtura rezulton që numri në total I vizitorëve të huaj dhe vendas që kanë vizituar zonat e mbrojtura të Qarkut Vlorë është 762,450 vizitorë të huaj dhe vendas për 2023.

| **QARKU** | **Vizitorë në Zonat e Mbrojtura (vendas)** | | **Vizitorë në Zonat e Mbrojtura (të huaj)** |
|---|---|---|---|
| | **2022** | **2023** | **2022** |
| **Vlora** | 417,693 | 368,522 | 232,460 |

*Burimi: Agjencia Kombëtare e Zonave te Mbrojtura*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 16.01.2024 | Kërkesë për informacion ne lidhje me:<br>1-Sa eshtë numri i akteve ligjore qe keni konsultuar me Organizata jofitimprurëse gjate vitit 2023?<br>2-Kush kane qene format e konsultimit qe keni përdorur?<br>3- Sa është numri i OJF-ve që kanë marrë pjesë  në këto konsultime?<br>4-A ka institucioni juaj koordinator për njoftim dhe konsultim publik? Nëse po ju lutem citoni kontaktin.<br>5- A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po ju lutem citoni kontaktin.<br>6- a ka organe këshillimore që | 29.01.2024 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2023 ka hedhur për konsultim publik ne Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimin  gjithsej 8 akte, te cilat ishin ne përputhje me  Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për vitin 2023.<br>Format e konsultimit publik qe janë përdorur kane qene: Regjistri Elektronik i Njoftimit dhe Konsultimit Publik;  Takime konsultative me grupet e interesit; Dëgjesa Publike; Posta Elektronike, posta zyrtare.<br>Numri i Organizatave jofitimprurëse qe kane komentuar ne regjistrin elektronik ose nëpërmjet e-mail-eve është 10.<br>Koordinator për konsultimin publik, znj. Meri Toci, Meri.toci@turizmi.gov.al   gjithashtu te dhënat janë te publikuara ne faqen zyrtare te ministrisë: https://turizmi.gov.al/programi-i-transparences-2-2/<br>Në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ka një rubrikë të veçantë dedikuar Konsultimit Publik. Në të, të gjithë palët e interesuara mund të shprehin sugjerimet, komentet, rekomandimet dhe propozimet e tyre. Link-un: https://turizmi.gov.al/konsultime/<br>Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit<br>Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit (KKSPT), është një organ këshillimor për sektorin e turizmit. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të KKSPT-së përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.<br>Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga:<br>a) shoqatat kombëtare të sipërmarrjeve, që operojnë në fushën e turizmit apo të lidhura me to;<br>b) përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë; | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | funksionojnë pranë institucionit tuaj? Nëse po, ju lutem listojini ato.<br>7- A janë të përfshirë te OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po, sa është numri i OJF-ve të përfshira ne to?<br>8- Gjatë 2023, a ka patur institucioni juaj grupe të përbashkëta pune me pjesëmarrjen e OJF-ve? Nëse po ju lutem përmendeni:<br>*Qëllimin e grupeve<br>*Numrin e OJF-ve pjesëmarrëse<br>* Mënyrën e përzgjedhjes së OJF-ve.<br>9- A është trajnuar stafi juaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa | | c) dhomat e tregtisë;<br>d) përfaqësues të shoqatave apo OJF-ve, që operojnë në fushën e Turizmit;<br>e) përfaqësues të institucioneve /donator ndërkombëtarë;<br>Përfaqësues të OJF-ve janë të përfshirë në organe këshillimore siç është ajo e Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit (KKSPT).<br>· Mënyra e përzgjedhjes së OJF-ve Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2023 në faqen zyrtare www.turizmi.gov.al ka shpallur për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, privatë ose publikë, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, në funksion të realizimit të misionit strategjik: “Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit” duke synuar promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike për zhvillimin e turizmit malor, natyror, kulturor, tradicional, kulinar, ekoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës etj., në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik për vitin 2023.<br>Mënyra e përzgjedhjes së projekteve fituese është kryer në mbështetje të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, të pikës 11, të Vendimit të Këshillit të Minstrave nr. 281/2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, të pikës 15, të Urdhrit të Ministrit nr. 21, datë 23.01.2023 “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”, si dhe të Urdhrit të Ministrit nr. 73 datë 02.03.2023 “Për miratimin e projekteve në turizëm që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | punonjës janë trajnuar dhe nga kush?<br>10- A ofron institucioni Juaj licencuar për shërbime te caktuara që ofrohen nga OJF-të? Nëse po, ju lutem specifikoni llojin/et e shërbimit? Sa është numri I OJF-ve të licencuar sipas llojit/llojeve të shërbimesh? | | shtetit", ku në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së projekteve që iu përgjigjën Thirrjes së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbështetje financiare të projekteve në Turizëm, për vitin 2023, si dhe bazuar në vlerësimin e detajuar mbi dokumentacionin e dorëzuar, kohëzgjatjen e projektit, fondit për financimin e kërkuar, veprimtarinë e deritanishme të tyre, kontributit në fushën ku operojnë, përputhshmërinë e objektivave me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit etj., me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në turizëm, janë zgjedhur projektet e miratuara nga aplikimet e paraqitura. | | |
| 4. | 16.01.2024 | Kërkese për informacion ne lidhje me: Numrin e aktiviteteve "Hotel" të regjistruara në Bashkinë e Vlorës<br>2) Nëse tërësia e këtyre strukturave përfiton nga aplikimi 6% i TVSH sipas Ligjit 92/2014 "Për TVSH" | 25.01.2024 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka listën e strukturave akomoduese te cilat kane aplikuar pranë institucionit tone për t'u certifikuar, te cilat i gjeni ne linkun: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/tabela-kategorizim-04.10.2023.pdf<br><br>Për sa i përket pyetjes për strukturat që përfitojnë 6% ky ë është një informacion qe mund t'ju jepet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Përfunduar | 0 |
| 5. | 17.01.2024 | Në kuadër të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër - Dekarbonizimi, | 30.01.2024 | Kërkesë për informacion në kuadër të Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër – Dekarbonizimi" lutem gjeni si | Përfunduar | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kërkojmë të dhënat zyrtare për nivelin e zbatimit për Ecurinë (politikat, aktivitetet) dhe Hapat e radhës për aktivitetet:<br><br><br><br>1. Harmonizimi me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.<br>2. Vendosni objektiva afatgjata për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030.<br>3. Përgatitni dhe zbatoni strategjitë e përshtatjes ndaj klimës.<br>4.Të harmonizohet me Sistemin e BE-së për Tregtimin e Emetimeve dhe/ose të prezantojë instrumente të tjera të çmimeve të karbonit<br>5. Rritja e mundësive për vendosjen e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të zbutur | | bashkëlidhur raportin mbi nivelin e zbatimit/planet për përmbushjen e angazhimeve në Republikën e Shqipërisë:<br><br>1. Harmonizimi me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.<br><br>Shqipëria ka treguar angazhim të vazhdueshëm për të reduktuar emetimet e gazeve serrë nga sektorët ekonomikë, si edhe përmes politikave ambicioze për rritjen e sipërfaqeve pyjore.<br><br>Kontributi Kombëtar i Përcaktuar 2021-2030 (NDC) nxjerr në pah angazhimin e Republikës së Shqipërisë (i) për zvogëlimin e emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë (GES), (ii) objektivat e vendit lidhur me klimën, si dhe (iii) politikat dhe masat që qeveria shqiptare synon të zbatojë në përgjigje të ndryshimit të klimës dhe si një kontribut për të arritur objektivat globale të përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit mbi Klimën (Marrëveshja e Parisit).<br><br>Nëpërmjet Kontributit Kombëtar të Përcaktuar i rishikuar, vendi ynë synon të reduktojë emetimet e gazeve me efekt serrë me 20.9% deri në vitin 2030.<br><br>Shqipëria ka ndërmarrë hapa shumë të rëndësishëm nëpërmjet hatimit të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike dhe planeve të veprimit, duke përfshirë veçanërisht sektorët e energjisë dhe transportit, por edhe bujqësinë, pyjet, administrimin e mbetjeve, industrinë.<br><br>Më 2 korriku 2019, Qeveria e Shqipërisë ishte vendi i parë në Rajon me një Strategji të miratuar për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe përshtatur me ndryshimet klimatike<br>6.Të sigurojë pjesëmarrjen e ekonomive të BP në Paktin Evropian të Klimës ose të marrë në konsideratë zhvillimin e një mekanizmi të ngjashëm.<br>7.Prioritizimi i efikasitetit të energjisë dhe përmirësimi i tij në të gjithë sektorët. | | Ndryshimet Klimatike, dhe përkatësisht Plane Veprimi për Zbutjen dhe Përshtatjen, që përfaqëson një strategji të përgjithshme ndërsektoriale me objektiva politikash dhe veprime konkrete për: zvogëlimin e emetimeve të GES dhe rritjen e elasticitetit ndaj ndryshimeve klimatike.<br><br>Në përputhje me përpjekjet e BE-së për ndryshimet klimatike dhe detyrimet tona përkatëse në procesin e anëtarësimit në BE janë miratuar aktet ligjore si më poshtë:<br><br>- ligji nr. 155/2020 për “Ndryshimet Klimatike”<br><br>- Kontributi Kombëtar i Përcaktuar<br><br>- Plani kombëtar i Energjisë dhe Klimës<br><br>- Përafrimi i “Rregullores së Qeverisjes”<br><br>- Ligji nr. 2/2023 “Për gazet serrë të fluoruara”<br><br>Për arritjen e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050, Shqipëria do të zhvillojë dhe miratojë Strategjinë Afatgjatë të Emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë të ulët kur të rishikojë Strategjinë<br><br>Kombëtare aktuale për Ndryshimet Klimatike, në përputhje me dispozitat e Ligjit të BE-së për Klimën..<br><br>2. Vendosni objektiva afatgjata për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030.<br><br>Për të mbështetur objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër të Bashkimit Evropian, Shqipëria dhe vendet e Ballkanit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Perëndimor nënshkruan dy Deklarata në Samitin e Sofjes në nëntor 2020: vendet e Ballkanit Perëndimor në Axhendën e Gjelbër, si dhe krijimin e një Tregu të Përbashkët Rajonal që synon të ta bëjë ekonominë të qëndrueshme dhe neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050, nëpërmjet një sërë iniciativash dhe reformash gjithëpërfshirëse politike dhe financiare.<br><br>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit miratuan Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në përputhje me kuadrin ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe Acquis të BE-së.<br><br>Objektivat specifike të synuara në këtë plan deri në vitin 2030, lidhen me:<br><br>- Reduktimin e shkarkimeve të GES-ve (Reduktimi në raport me ËEM) me 18,7%;<br><br>- Efiçenca e energjisë (Reduktimi i Konsumit Final të Energjisë në raport me ËEM) me -8.4%;<br><br>- Rritjen e pjesës që zë energjia e rinovueshme në kërkesën finale për energji në nivelin 54.4%.<br><br>3. Përgatitni dhe zbatoni strategjitë e përshtatjes ndaj klimës.<br><br>Dokumenti i Strategjisë Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (SKZNK&PV) është hartuar, për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar përforcimin e koordinimit ndërsektorial në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shqipëri, për masat mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.<br><br>Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP), pjese e integruar e Dokumentit Strategjik ka për qëllim të reduktojë vulnerabilitetin, ndërtimin e kapaciteteve adaptuese (përshtatëse) dhe integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në të gjitha proceset e planifikimit dhe zhvillimit të sektorëve specifikë.<br><br>Objektivat specifikë të NAP-it:<br><br>• Objektivi 1: Reduktimi i dëmeve për shkak të përmbytjeve.<br><br>• Objektivi 2: Zgjerimi i aftësive ripërtëritëse të sektorit të bujqësisë kundrejt përmbytjeve.<br><br>• Objektivi 3: Sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm, pavarësisht nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.<br><br>NAP-i mund u hartua si një dokument “ombrellë” dhe jo si një plan operativ i hollësishëm që përcakton të gjitha veprimet e nevojshme për një proces të suksesshëm përshtatjeje në vend. Argumentimi për këtë parim vjen nga njohuria se veprimet e përshtatjes duhet të integrohen në<br><br>planet dhe politikat e ndryshme sektoriale dhe të zhvillimit në vend dhe duhet të përcaktohen në kuadër të tyre.<br><br>“Pjesa operative” e dokumentit të NAP-it nuk shkon përtej të ashtuquajturave veprime prioritare me funksione | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | strategjike dhe funksione levë (të ashtuquajtura “projekte ombrellë”) dhe veprimeve sektoriale me prioritet të lartë, për të cilat qeveria shqiptare merr një vendim konkret për zbatim. Rekomandohet që këto të jenë të kufizuara në numër dhe të zbatohen me përfshirjen e të gjitha palëve përkatëse të interesit. Në tabelën e mëposhtme jepet një paketë me 15 veprime prioritare, për të cilat është rënë dakord gjatë mbledhjes së Grupit Ndërministror të Punës, më 8 shtator 2015.<br><br>Lista e veprimeve prioritare ndahet në dy rubrika:<br><br>Veprimet gjithëpërfshirëse, në pjesën e parë do ta orientojnë dhe mbështetin procesin e NAP-it dhe pas miratimit të dokumentit do të kuptohen si “kuadri zbatues” i procesit.<br><br>Veprimet prioritare sektoriale dhe ndërsektoriale tematike, limitohen vetëm në zonat e veprimit, të cilat sigurojnë lidhje strategjike për procesin e NAP-it në total.<br><br>Çdo veprim prioritar është përgatitur bashkërisht me anëtarët e grupit punës ndërministror, sipas një formati të standardizuar, i cili përfshin:<br><br>• Situatën ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar. Këtu shpjegohet kryesisht vlera e shtuar që rrjedh nga veprimi prioritar.<br><br>• Arsyetimin, objektivat dhe treguesit e veprimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 17.01.2024 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare | 29.01.2024 | Kthyer përgjigje me shkresë | Përfunduar | 0 |
| 7 | 19.01.2024 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare | 29.01.2024 | Kthyer përgjigje me shkresë | Përfunduar | 0 |
| 8 | 22.01.2024 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare | 29.01.2024 | Kthyer përgjigje me shkresë | Përfunduar | 0 |
| 9 | 26.01.2024 | Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie te informacionit dhe kopje te dokumentacionit zyrtare | 31.01.2024 | Kthyer përgjigje me shkresë | Përfunduar | 0 |